RRETH PROJEKIT

Projekti **HAZADR** do të zbatohet nën **Programin IPA Adriatik për Bashkëpunimin Ndërkufitar**. Ai është plotësisht koherent me objektivin e përgjithshëm të programit – Forcimi i zhvillimit të qëndrueshëm të kapaciteteve në rajonin e Adriatikut, nëpërmjet një strategjie të përbashkët veprimi midis partnerëve, brenda të cilit ky program mbështet Prioritetin 2 –Burimet Natyrore e Kulturore dhe Parandalimi i Riskut, Masa 2.2 Menaxhimi i Burimeve Natyrore dhe Kulturore dhe Parandalimi i Risqeve Natyrore dhe Teknologjike.

Objektivi kryesor është krijimi i një rrjeti ndër–kufitar për parandalimin e riskut dhe menaxhimin e emergjencave për të reduktuar riskun e ndotjes në detin Adriatik dhe forcimin e një kapaciteti të përbashkët reagimi të komuniteteve të rajonit të Adriatikut kundër rreziqeve mjedisore dhe teknologjike që vijnë si shkak i përplasjeve, mbytjeve të anijeve dhe derdhjes së naftës dhe materjaleve toksike në det.

Objektivat specifike që do të arrihen nëpermjet bashkëpunimit aktiv të autoriteteve portuale, rojeve bregdetare dhe trupave ushtarake janë:

___ Përmirësimi i kuadrit njohurie mbi vlerësimin e rreziqeve mjedisore dhe socio – ekonomike në zonat me vulnerabil të Adriatikut si shkak i faktorëve natyrorë dhe njerëzorë si dhe harmonizimi i kuadrit ligjor për mbrojtjen e detit nga ndotja në vendet e Adriatikut, për të mbështetur procesin e vendimmarrjes në parandalimin, reagimin dhe kapërcimin e emergjencave (gjithashtu për përfitimin e vendeve të cilët nuk janë të përfshirë direkt në këtë projekt por që ndikohen nga derdhjet e naftës në rastet e mbytjeve apo të përplasjeve të anijeve).

OBJEKTIVAT SPECIFIKE

___ Përmirësimi, harmonizimi dhe shkurtimi i kohës së reagimit ndër-kufitar ndaj derdhjes së naftës, substancave toksike dhe të rrezikshme duke rritur kapacitetet koordinuese/ reaguese në EURORAJONIN Adriatik të personelit të ngarkuar për t'iu përgjigjur rreziqeve ekologjike (për tu zbatuar më tej nga të gjithë partnerët sipas çdo ligji kombëtar, në përputhje me EU-në dhe marrëveshjet ndërkombëtare dhe në lidhje me trupat për mbrojtjen civile në tokë).

___ Ngritja e një baze të dhënash (database) të përbashkët mbi gjendjen e gatishmërisë dhe pajisjeve për parandalimin e përhapjes së ndotjes përgjatë bregut Adriatik si dhe përmirësimin e pajisjeve operacionale për të përballuar rreziqet teknologjike dhe mjedisore.

___ Përmirësimi nëpërmjet 2 ushtrimeve të përbashkëta ndër-kufitare në Adriatik, dhe ngritjen e një Qendre Trajnimi dhe Kërkimi për kapacitetet reaguese ndër-kufitare. Kjo do të kryhet nëpërmjet trajnimit të personelit drejtues, stafit operues dhe të aktorëve të tjerë të përfshirë në planin e emergjencës dhe parandalimit të ndotjes, për të zgjeruar njohuritë dhe aftësitë e tyre vendimmarrëse, shkallën hierarkike si edhe përdorimin e pajisjeve dhe çështje të tjera.

___ Përmirësimi i një sistemi të paralajmërimit të hershëmnëpërmjet një programi të përbashkët monitorimi, bazuar në një set sistemi radarësh dhe pajisjeve VHF në mënyrë që kapacitetet e aktorëve te Eurorajonit të identifikojnë burimet potenciale të risqeve kërcënuese të ekosistemit (të lokalizuara kryesisht në pjesët më të ndjeshme ekonomike të Adriatikut) dhe nxitjen e procedurave të ndërhyrjes së koordinuar.

EFEKTET AFAT GJATA TE PROJEKTIT

Pas përfundimit të projektit aktivitetet e lidhura me rritjen e gatishmërise dhe të kapaciteteve reaguese, për reagimin ndaj mekanizmave në det, në nivel ndër –kufitar dhe rajonal do të jenë në vazhdimësi.

Roli kyç do të kryhet nga Qëndra e Trajnimit dhe Kërkimit që do të vazhdojë operimin e saj edhe pasi projekti të jetë finalizuar.
Qëndra do të jetë nën pronësine e Qarkut Primorsko-Goranski, Kroaci. Meqënëse partnerët e projektit janë institucione publike dhe tepër të motivuara për ngritjen e një Qëndre Trajnimi, financimi ekstra i kësaj qëndre konisderohet lehtësisht i qendrueshëm. Në tërësi njohuritë dhe eksperienca e fituar nga bashkëpunimi ndër-kufitar do të përdoret në të ardhmen në mënyre për të mbajtur në nje niveli të lartë përgatitjen ndaj situatave emergjente në det. Pas përfundimit të aktiviteteve të projektit puna për hartimin e planeve rajonale dhe të emergjencës do të vazhdojë për ato rajone dhe qarqe ku plane të tilla nuk kanë filluar akoma të elaborohen; implementimi i ushtirimeve ndër-kufitare do te vazhdojë përsëri. **HAZADR** siguron një baze te mirë për një qëllim të veçantë: Udhëzime për hartimin e planeve të emergjencës që do të shërbejnë si referencë për rajonet qe nuk kanë hartuar apo miratuar një të tille.

Do të perdoren metodologji për implementimin e ushtrimeve ndër-kufitare si referencë për organizimin e ushtirmeve të tilla ne të ardhmen si dhe për vleresimin e efikasitetit. Impakti më i rëndesishëm i këtij projekti do të jenë Udhëzimet per hartimin e planeve të emergjencës, por gjithashtu propozimet që partnerët e projektit do tju paraqesin organeve kompetente kombëtare, organeve te EU-së dhe organizatave ndërkombetare ku ata theksojnë nevojën për përmirësimin e legjislacionit e cila është baza për mbrojtjen detare duke përfshire edhe harmonizimine e procedurave të reagimit.

HISTORIKU

___ **Deti Adriatik eshte** nje nga zonat më të rrezikuara ne Mesdhe. Ai përballet me sfida serioze mjedisore veçanërisht si shkak i rrugëve të dendura të transportit të naftës për portet e Triestes Venecias, Koper dhe Omisalj në Veri të Adriatikut. Nga një pikëpamje ekonomike zona e Adriatikut luan një rol të rëndësishëm në turizëm dhe argëtim. Në të njëjtën kohe është edhe një nga zonat industriale më të zhvilluara. Si rrjedhojë rreziku dhe kërcënimi nga nafta, substancat toksike dhe të rrezikshme, mund të kenë pasoja katastrofike për mjedisin ashtu si edhe për aktivitetet ekonomike detare.

Deri tani kjo zonë ka qenë e prekur nga incidente të shumta detare që fatmirërisht nuk kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme në mjedis. Edhe pse këto incidente nuk kanë shkaktuar pasoja, janë zbuluar mangësi të shumta në sistemin e mbrojtjes ekzistuese detare. Kjo ka të bëjë se pari me pajisjet e disponueshme në rajonet apo qarqet ne te cilat janë të pamjaftueshme të përballojnë katastrofat e mëdha mjedisore.

Probleme të tjera që ndikojnë në të dy brigjet e Adriatikut janë mungesa e ekipeve reaguese të trajnuara dhe të koordinuara, që duhet të merren me aksidentet komplekse në det ashtu si edhe koordinimin modest ndër-kufitar, midis organeve të përfshira në zbatimin e planeve të emergjencës. Kjo situatë ndodh për faktin se nuk ekziston një qendër trajnimi dhe kërkimi në rajonin e Adriatikut, si edhe disa vende dhe rajone të Adriatikut nuk kanë plane emergjence duke i përkeqësuar gjërat.



Kohëzgjatja e projektit është 30 muaj duke filluar nga Tetori 2012, dhe drejtohet nga Shërbimit i Mbrojtjes Civile -Rajoni Puglia, Itali, në bashkëpunim me këto partnerë:

- Qarkun Primorsko-Goranska, Kroaci
- Qarkun Zadar, Kroaci
- Qarku Split –Dalmaci, Kroaci
- Qarku Istria, Kroaci
- Rajoni i Emilia-Romagna, Itali
- Rajoni Marche, Itali
- Instituti i Kërkimit Kombëtar Italian (CNR IRSA), Itali
- Instituti Kombëtar i Oqeanografikes dhe Gjeofizikës Ekspermentale (OGS), Itali
- Instituti i Oqeanografikes dhe Peshkimit të Splitit, Kroaci
- Ministria e Punëve Publike dhe Transportit – Drejtoria e Politikave të Transportit Detar, Shqipëri
- Stacioni i Biologjisë Detare të Piranit (MBSP), Instituti Kombëtar i Biologjise (NIB), Slloveni
- Universiteti i Malit të Zi – Instituti i marinës biologjike (IMBK), Mal i Zi

HAZADR

Strengthening common reaction capacity to fight sea pollution of oil, toxic and hazardous substances in Adriatic Sea

FORCIMI I KAPACITETEVE TË PËRBASHKËTA PËR TË LUFTUAR NDOTJEN NGA NAFTA, SUBSTANCAT TOKSIKE DHE TË RREZIKSHME NË DETIN ADRIATIK

Kjo broshurë është prodhuar me ndihmën financiare të Programit IPA Adriatik për Bashkëpunimin Ndër- Kufitar. Përmbajtjet e kësaj broshure eshtë përgjegjësi e vemte e Ministrisë së Tranpsortit dhe Punëve Publike dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet si reflektim i Autoriteteve të Programit IPA Adriatik për Bashkëpunimin Ndër-Kufitar.

Let's grow up together Adriatic IPA Cross Border Cooperation 2007-2013

Ky projekt është bashkë financim i Bashkimit Europian, Asistenca e Instrumentit te Para – Aderimit.